FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 64 13 qershor 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.23/2012 datë 11.6.2012	Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.....	3143
Dekret nr. 7503 datë 1.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3143
Vendim i KM nr. 313, datë 9.5.2012	Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve".....	3144
Vendim i GJK nr. 33, datë 24.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.19, datë 07.05.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; të vendimit nr.50, datë 01.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.394, datë 08.07.2009 të Gjykatës së Lartë.....	3147
Vendim i GJK nr. 34, datë 28.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimin nga statusi i të verbrit", ndryshuar me VKM-të nr.870, datë 18.06.2008 dhe nr.602, datë 23.07.2010.....	3154
Vendim i GJK nr. 35, datë 30.5.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	3162
Udhëzim i KMDHP nr. 17, datë 11.5.2012	Mbi përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e Policisë së Shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale.....	3166

Vendim i ERE nr. 59, datë 10.5.2012	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Power Elektrik Sllabinjë" sh.p.k. me nr. 93, seria PV10K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010……	3169
Vendim i ERE nr. 60, datë 10.5.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë hec "Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike……	3170
Vendim i ERE nr. 61, datë 10.5.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "GJO SPA Power" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Lapaj"……	3171
Vendim i ERE nr. 62, datë 10.5.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "GJO SPA Power" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike….	3172
Vendim i ERE nr. 63, datë 10.5.2012	Për licencimin e shoqërisë "Kurum Energy" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike……	3172
Vendim i ERE nr. 64, datë 10.5.2012	Për licencimin e shoqërisë "Kurum Energy" sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike……	3173
Vendim i ERE nr. 65, datë 28.5.2012	Për licencimin e shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3"……	3174

VENDIM
Nr. 23/2012

PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 86, 87 dhe 88 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 109 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Bujar Nishani zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 11.6.2012

DEKRET
Nr. 7503, datë 1.6.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Etrit Fadil Berisha
2. Shpend Hajdin Matoshi
3. Lèotrim Agim Gashi
4. Xhelbrim (Gjelbrim) Izir Taipi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr. 313, datë 9.5.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA SHKARKIMET NË MJEDIS, PËRCAKTIMIN E MOSTRAVE, RAJONEVE DHE FREKUENCËS SË MATJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA SHKARKIMET NË MJEDIS, PËRCAKTIMIN E MOSTRAVE, RAJONEVE DHE FREKUENCËS SË MATJEVE

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet e mbrojtjes së publikut dhe mjedisit, në tërësi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve jonizuese me qëllim mbrojtjen e shëndetit të publikut.

Neni 2
Monitorimi i radioaktivitetit

1. Monitorimi i radioaktivitetit të mjedisit nënkupton matje bazë të cilat lidhen me përqendrimin e radionuklidëve në ajër, ujë dhe tokë. Për të realizuar një përputhje të mirë me standardet bazë të sigurisë, përveç radioaktivitetit të ajrit, ujit dhe tokës të përcaktohet edhe niveli i radioaktivitetit të mostrave biologjike dhe në veçanti të ushqimeve.
2. Ekspozimi i popullatës që vjen nga radioaktiviteti i mjedisit vlerësohet në mënyrë më direkte dhe të plotë në bazë të ndotjes së ushqimeve. Monitorimi i mjedisit përfshin dhe monitorimin e niveleve të radioaktivitetit të biotave të ndryshme si ushqimi për njerëzit, ushqimi për kafshët, si dhe vetë bimësia.
3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbi bazën e të dhënave që i japin institucionet monitoruese publikon çdo vit një raport monitorimi.
4. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi me propozim të institucioneve monitoruese, si dhe duke ju referuar raportit vjetor të monitorimit dhe problematikave në mjedis përcakton llojet e mostrave dhe të radionuklideve që duhet të monitorohen dhe që janë tregues të niveleve aktuale dhe potencialeve të radioaktivitetit në mjedis, që ndikojnë në ekspozimin e popullsisë.

5. Këto nivele monitorimi në mjedis janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Ministria e Mjedisit nëpërmjet institucioneve monitoruese.

Neni 3
Rrjeti monitorues

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi me propozim të institucioneve monitoruese përcakton rajonet përfaqësuese gjeografike për territorin e vendit që do të bëjnë pjesë në rrjetin e monitorimit. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi përcakton për çdo tip mostre një rrjet monitorimi të dendur dhe të rrallë sipas një frekuence të caktuar.

2. Institucionet monitoruese janë persona fizikë juridikë ose fizikë të njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi të cilët kanë kapacitetet teknike dhe pajisje për të kryer monitorimin e mjedisit bazuar në kriteret e miratuara dhe publikuara më parë prej KMR-së.

3. Institucionet monitoruese paraqesin pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi të gjithë procedurën e monitorimit dhe kampionimit. Kjo procedurë vlerësohet dhe aprovohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

4. Rajonet që përbëjnë rrjetin monitorues të përfaqësojnë situatën rajonale, të marrin parasysh shpërndarjen e popullsisë dhe të aktiviteteve prodhuese në atë rajon.

Neni 4
Llojet e mostrave, tipat e matjeve dhe periodicitetit

1. Llojet e rekomanduara të mostrave dhe të matjeve janë si më poshtë:

Lloji i mostrës	**Lloji i matjeve**	
	Rrjet monitorimi i dendur (mujore)	**Rrjet monitorimi i rrallë (tremujore)**
Aerozole	Cs-137, beta total	Cs-137, Be-7
Ajër	Fuqia e dozës gama mjedisore	Fuqia e dozës gama mjedisore
Ujë sipërfaqësor	Cs-137, beta total	Cs-137
Ujë i pijshëm	H-3, Sr-90, Cs-137 Radionuklidet natyrore	H-3, Sr-90, Cs-137 Radionuklidet natyrore
Qumësht	Cs-137, Sr-90	Cs-137, Sr-90, K-40
Dietë e përzier	Cs-137, Sr-90	Cs-137, Sr-90, C-14

2. Rekomandohet që për rrjetet monitoruese të dendura matjet të kryhen çdo muaj, ndërsa për ato të rralla çdo tre muaj.

Neni 5
Strategjia e marrjes së mostrave dhe matjet në lidhje me çdo lloj mostre

1. Marrja e mostrave bëhet në mënyrë të tillë që të na paraqesin një vlerësim sa më të plotë të radioaktivitetit në mjedis. Këto mostra përfshijnë:

a) Aerozole

Për aerozolet kryhen në mënyrë rutinore matja e radionuklidëve gama emetuese artificiale dhe natyrore. Institucionet monitoruese raportojnë gjithashtu rezultatet e matjeve beta totale dhe ato për beriliumin-7. Vendet e marrjes së mostrave duhet të zgjidhen pranë zonave me popullsi të dendur me një mbulim gjeografik sa më të mirë të territorit duke zgjedhur të paktën një vend për marrjen e mostrave në një rajon gjeografik.

b) Ajër

Lidhur me ajrin kryhen matje të vazhdueshme për fuqinë e dozës gama mjedisore.

c) Ujë sipërfaqësor

Marrja e mostrave kryhet për ujërat e brendshme kryesore dhe për ujërat bregdetare.

Në rastin e ujërave të lumenjve, mostrat merren në zonat ku njihet debiti (prurja) e rrjedhjes. Për këto mostra kryhet monitorimi i radionuklidëve gama emetuese dhe i matjeve beta totale.

d) Ujë i pijshëm

Institucionet monitoruese raportojnë vlerat për furnizuesit kryesorë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe për rrjetet e shpërndarjes së ujit. Pikat e marrjes së këtyre mostrave duhet të jenë të tilla që të mbulojnë në mënyrë përfaqësuese rajonin.

Gjithashtu të raportohet vlera korresponduese e volumit të ujit të shpërndarë ose të prodhuar gjatë një viti për secilën pikë të marrjes së mostrës.

e) Qumësht

Mostrat e qumështit duhet të merren nga pikat e prodhimit, si dhe të raportohet edhe sasia e prodhuar nga secila pikë. Pikat e marrjes së këtyre mostrave duhet të jenë të tilla që të mbulojnë në mënyrë përfaqësuese rajonin. Monitorimi duhet të përfshijnë matjet Cs-137, Sr-90 dhe K-40.

f) Dietë e përzier ushqimore

Matja e dietës së përzier ushqimore është një indikator shumë i rëndësishëm i ekspozimit të popullatës. Për të përcaktuar radioaktivitetin e dietës së përzier mund të përcaktohet radioaktiviteti i përbërësve të saj ose i një racioni të zakonshëm ushqimor.

Monitorimi i dietës së përzier përfshin emetuesit gama dhe Sr-90. Ky monitorim duhet të kryhet për intervale 3-mujore.

Neni 6

Rekomandime bazë për monitorimet sipas mostrave, matjeve dhe frekuencave

1. Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi bazohet në rekomandimet e mëposhtme për monitorimet sipas mostrave, matjeve dhe frekuencave. Këto monitorime komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi i miraton të paktën çdo 5 vjet, por dhe më shpesh kur ka ndryshime mjedisore. Monitorimet sipas mostrave janë si më poshtë:

a) Mostra për aerozolet

Gama: Cs-137, Pb-210, K-40, Be-7 (çdo muaj)

Total alfa-beta

Alfa: U-238, U-234, Pu-239 dhe 240

b) Mostra depozitimi ose precipitimi (Fall-out) nga shirat dhe pluhurat nga atmosfera

Gama: Cs-137, Pb-210, K-40, Be-7 (çdo muaj)

Total alfa-beta (çdo muaj)

c) Mostra Bari

Gama: Cs-137, K-40 (dy herë në vit)

d) Mostra toke

Gama: Cs-137, K-40, Ra-226, Th-232 (dy herë në vit)

Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

Alfa: U-238, U-234, Pu-239+240 (dy herë në vit)

e) Mostra ujë i pijshëm

Alfa: U-238, U-234, Po-210 (dy herë në vit)

Total alfa-beta (katër herë në vit) Rn-222 (për nivele mbi 40 Be/l, tri herë në vit dhe për nivele nën 40 Bql/l, një herë në vit)

ë) Mostra qumështi

Gama: Cs-137, K-40 (dy herë në vit)

Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

f) Matjet në ajër
Fuqia e dozës së rrezatimit gama në ajër (matje ditore)
g) Dieta e përzier ushqimore
Gama: Cs-137 (dy herë në vit)
Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

Neni 7
Rrjeti kombëtar i monitorimit të radioaktivitetit

1. Referuar shpërndarjes së popullatës dhe aktiviteteve prodhuese në raport me monitorimin e radioaktivitetit në mjedis, vendi ynë ndahet në tre rajone përfaqësuese:
a) Rajoni i Shqipërisë Veriore;
b) Rajoni i Shqipërisë së Mesme;
c) Rajoni i Shqipërisë Jugore.
2. Për secilin rajon përcaktohen pikat e kampionimit si më poshtë:
a) Rajoni i Shqipërisë Veriore përfshin Shkodrën dhe Kukësin;
b) Rajoni i Shqipërisë së Mesme përfshin Tiranën Durrësin dhe Elbasanin;
c) Rajoni i Shqipërisë Jugore përfshin Vlorën, Gjirokastrën dhe Korçën.
3. Për Tiranën të përcaktohen dy pika kampionimi, kurse për qytetet e tjera të përcaktohet një pikë kampionimi.

VENDIM
Nr. 33, datë 24.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i “	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“

me sekretare Elta Milori, në datat 15.12.2011 dhe 22.12.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 52/27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Fredi Aliaj, përfaqësuar nga avokat Theodhori Sollaku, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.19, datë 07.05.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; i vendimit nr.50, datë 01.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr.394, datë 08.07.2009 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 48, 49, 50/1, 74, 75/a, 83/1 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.19, datë 07.05.2007, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale "të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese", të kryer në bashkëpunim dhe duke i shkaktuar mundime të veçanta viktimës, parashikuar nga neni 79/e dhe 25 i Kodit Penal (KP) dhe e ka dënuar atë me 23 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.50, datë 01.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kërkuesin dhe ndryshimin e këtij vendimi për të pandehurit e tjerë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.394, datë 08.07.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për kërkuesin.

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, pasi këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

4.1. *Është cenuar e drejta e gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*. Vepra penale, e parashikuar në nenin 79/e dhe 25 të KP-së, nuk është në kompetencën lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda, por në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për rrjedhojë, gjykimi i çështjes nga gjykata jokompetente vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, nenet 74, 75/a dhe 83 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

4.2. *Është cenuar e drejta e mbrojtjes*. Kërkuesi është gjykuar në mungesë dhe mbrojtësi i tij, në kundërshtim me nenin 31/ç të Kushtetutës, nenin 50/1 të KPP-së dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, është zgjedhur nga të afërmit pa dijeninë dhe autorizimin e tij.

II

A. ***Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.***

5. Kërkuesi pretendon se është gjykuar nga Gjykata për Krime të Rënda për veprën penale "të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79 shkronja "e" i KP-së kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, është cenuar e drejta kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

6. Gjykata Kushtetuese rithekson se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që kanë lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara (*shih vendimet nr.1, datë 25.01.2010; nr.36 datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

7. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuesi,

përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr.6, datë 04.03.2010; nr.32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

8. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 28.01.2004 ka regjistruar procedimin penal nr.131 në ngarkim të shtetasve Fredi Aliaj e të tjerë, për veprën penale "të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese" në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79, shkronja "e" dhe 25 të KP-së.

9. Me vendimin e datës 16.03.2004, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në mbështetje të neneve 75/a, 28 dhe 84 të KPP-së, të ligjit nr.9110, datë 24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krime të Rënda" dhe të urdhrit nr.227, datë 19.12.3003 të Prokurorit të Përgjithshëm, ka shpallur moskompetencën lëndore për vazhdimin e hetimeve për këtë procedim penal dhe kalimin e akteve Prokurorisë për Krime të Rënda. Kjo e fundit, në datën 25.03.2004 ka regjistruar procedimin nr.100 dhe në datën 20.10.2004 ia ka kaluar dosjen për gjykim, sipas kompetencës lëndore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka zhvilluar seancën e parë gjyqësore në datën 16.11.2004.

10. Ndërkohë, në datën 22.10.2004 ka hyrë në fuqi ligji nr.9276, datë 16.09.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", neni 4 i të cilit parashikonte, midis të tjerash, se kompetenca lëndore e gjykimit të veprës penale, parashikuar nga neni 79/e, nuk i përkiste më gjykatave të krimeve të rënda, por gjykatave të zakonshme të rretheve gjyqësore.

11. Gjatë gjykimit të çështjes, konkretisht në seancën e datës 03.02.2005, rezulton se mbrojtësit e të pandehurve kanë pretenduar moskompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga prokurori i çështjes dhe është rrëzuar nga Gjykata me arsyetimin se ligji nr.9276, datë 16.09.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë" nuk ka dispozita kalimtare për kompetencën e gjykimit të çështjeve të regjistruara pranë gjykatave. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vlerësuar kompetencën e saj, duke arsyetuar se çështja është regjistruar në datë 21.10.2004 dhe ligji ka hyrë në fuqi në datën 22.10.2004, pasi çështja është regjistruar.

12. Gjykata konstaton se kërkuesi apo mbrojtësi i tij nuk ka parashtruar pretendimin për moskompetencën lëndorë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në ankimin përpara Gjykatës së Apelit, apo në rekurs.

13. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, për rrjedhojë, nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së gjykimit të çështjes nga gjykata e caktuar me ligj.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

14. Kërkuesi pretendon se, gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime te Rënda, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe në Gjykatën e Lartë, i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit në mungesë të tij. Sipas kërkuesit, këto standarde kushtetuese janë cenuar pasi gjykatat nuk kanë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

15. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

16. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ),

Gjykata ka përcaktuar ndër vite disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë, sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë *(shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010, nr.45, datë, më 10.10.2011, nr.26, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin *(shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr.45, datë 10.10.2011; nr.26, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjykata, gjithashtu, është shprehur se duhet të pranohet mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, është detyrë e organeve kompetente shtetërore. Në këtë mënyrë, është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit *(shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr.45, datë 10.10.2011; nr.26, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Si konkluzion, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet të ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij *(shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr.45, datë 10.10.201; nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Veç sa me sipër, bazuar në kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit, të përcaktuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës me rezolutën (75) 11 *(shih vendimet nr. 45, datë 10.10.2011; nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese),* jurisprudenca e GJEDNJ-së ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar in absentia, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat *(Sejdovic kundër Italisë, 2000)*.

21. KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Detyra e GJEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që KEDNJ-ja kërkon, është arritur nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë *(shih vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr. 45, datë 10.10.2011, nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Gjithsesi, jo vetëm shkronja, por as dhe fryma e nenit 6 të KEDNJ-së nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Por, megjithatë, për qëllimet e KEDNJ-së do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoke dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së *(Colozza kundër Italisë, 1985)*.

23. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se " … njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari … për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme" *(Somogyi kundër Italisë, 18.05.2004)*.

24. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se në dosjen gjyqësore gjendet i administruar "Procesverbal për kërkimin e personit që nuk gjendet", i datave 23.04.2004 dhe 14.06.2004, sipas të cilit, edhe pas kontrollit të ushtruar në banesën e kërkuesit, ky i fundit nuk u gjet, pasi ishte larguar jashtë shtetit pa adresë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ndalohej dhe arrestohej. Në këto kushte, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.64, datë 22.06.2004, ka vendosur deklarimin e ikjes së kërkuesit dhe caktimin e mbrojtësit H.S. kryesisht. Ndërsa me prokurën e posaçme nr. 2800 rep, nr. 493 kol, datë 18.09.2004, nëna e kërkuesit ka caktuar si përfaqësues të kërkuesit, një mbrojtës tjetër, avokatin L.L. Pas deklarimit të ikjes së kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në seancën e datës 11.01.2005, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe e ka deklaruar kërkuesin në mungesë duke i caktuar atij si mbrojtës atë të zgjedhur nga familjarët (nëna e kërkuesit) me prokurën e posaçme të lartpërmendur. I njëjti mbrojtës ka përfaqësuar interesat ligjore të të pandehurit edhe në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe në Gjykatën e Lartë.

25. Gjithashtu, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se, në periudhën kohore nga 29.10.2004 deri më 24.01.2005 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka lëshuar shtatë "Urdhër mbi njoftimin e të pandehurve" drejtuar Policisë Gjyqësore pranë Komisariatit të Policisë Fier. Nga shkresë–përgjigjet e Policisë Gjyqësore pranë Komisariatit të Policisë Fier dhe nga raportet e shërbimit të Punonjësve të Policisë së Zonës, rezulton se kërkuesi nuk gjendet në banesë dhe as në ambiente të tjera të frekuentuara më parë prej tij, por është larguar jashtë shtetit, pa adresë. Ndërkohë, rezulton se fletë-thirrjet e gjykatës, drejtuar kërkuesit, janë marrë ose nga avokati i tij (fletëthirrjet e datave 29.10.2004) ose nga të afërmit e tij, konkretisht nga nëna e tij (fletëthirrjet e datave 23.12.2004) dhe daja (fletë-thirrja e datës 16.11.2004). Duke vlerësuar personat marrës të fletëthirrjeve, si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale si dhe formën e përmbajtjen e fletëthirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së.

26. Për sa i përket gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, nga dosja gjyqësore rezulton se në seancën e datës 12.09.2007, trupi gjykues ka vendosur se duke qenë se kërkuesi është gjykuar në mungesë gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe se ai me vendimin nr.64, datë 22.06.2004, është deklaruar i ikur, njoftimi për kërkuesin, është konsideruar i ezauruar,

konform nenit 247 të KPP-së, me depozitimin e urdhrit të thirrjes pranë mbrojtësit të tij L.L., i cili ka marrë dijeni efektivisht për seancat gjyqësore dhe ka qenë prezent në gjykimin e apelit. Ekzistojnë gjithashtu edhe fletëthirrjet për kërkuesin, për seancat e datave 12.07.2007 dhe 12.09.2007, të cilat janë nënshkruar respektivisht nga xhaxhai dhe nusja e xhaxhait të kërkuesit.

27. Sa më lart, Gjykata çmon se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit.

28. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë.

29. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar.

30. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit Fredi Aliaj, nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika "f" e 134, pika "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës[1].

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj .

Anëtarë kundër: Admir Thanza, Vitore Tusha.

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohemi me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por kemi mendim të ndryshëm në lidhje me arsyet për këtë qëndrim. Megjithëse kërkuesi ka pretenduar cenimin e të drejtës së mbrojtjes për shkak se, në gjykimin e zhvilluar në mungesë, ai është përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga familjarët pa dijeninë e tij, shumica, në arsyetimin e saj, të drejtën për t'u mbrojtur të të pandehurit në mungesë e ka interpretuar në këndvështrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, duke i lidhur integralisht këto dy të drejta në procesin e gjykimit në mungesë. Ne vlerësojmë se këto dy të drejta qëndrojnë veçmas edhe në procesin e gjykimit në mungesë, pavarësisht se bashkërisht janë parashikuar si garanci kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Meqenëse objekti dhe situata faktike e kësaj çështjeje janë të njëjta me ato të paraqitura në

[1] Gjyqtarët P. Plloçi dhe S. Berberi votuan pro rrëzimit të kërkesës, por me arsyetim paralel.

kërkesën e Ismet Boriçit, mbi të cilën Gjykata ka vendosur me vendimin nr. 26, datë 08.05.2012, për analogji, ne i qëndrojmë argumenteve që kemi parashtruar në mendimin paralel në atë çështje. Në mënyrë të përmbledhur, në vijim parashtrojmë arsyet te të cilat bazohet qëndrimi ynë.

Duke qenë se garantimi i të drejtës së mbrojtjes gjatë gjykimit në mungesë të të pandehurit është aspekt shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, jurisprudenca e kësaj Gjykate në këtë drejtim ka evoluar në funksion të forcimit dhe rritjes së standardeve kushtetuese, si dhe harmonizimit të koncepteve e garancive kushtetuese me praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Këto qëllime janë realizuar nga Gjykata nëpërmjet riinterpretimit të tekstit legjislativ të nenit 410/2 të KPP-së, të interpretuar më parë prej saj, duke nxjerrë nga ai një kuptim të ndryshëm të normës, pasi ka vlerësuar se kjo e fundit nuk mbart të meta nga pikëpamja e ligjshmërisë kushtetuese. Pas hyrjes në fuqi të vendimit riinterpretues nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës, kanë ndryshuar standardet e vlerësimit të së drejtës së mbrojtjes gjatë gjykimit në mungesë, e cila, në rastin e zgjedhjes së avokatit nga familjarët, garantohet vetëm në kushtet e ekzistencës së vullnetit të të pandehurit, që ushtrohet nëpërmjet familjarëve.

Ne vërejmë se procesi gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është zhvilluar në periudhën kohore 2007 – 2009, periudhë në të cilën, bazuar në interpretimet e bëra nga jurisprudenca kushtetuese, mbrojtësi i caktuar nga familjarët e të pandehurit kishte të drejtën për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë të të akuzuarit, në kushtet e nenit 410, paragrafi 2 të KPP-së, duke siguruar kështu parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit gjatë gjykimit. Kërkesa konkrete drejtuar Gjykatës me pretendimin, midis të tjerash, për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, si një nga komponentët e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është paraqitur pas datës 30.06.2010, e cila është data e hyrjes në fuqi të vendimit të ri interpretues, mbi bazën e të cilit janë përcaktuar standardet e reja dhe i është dhënë një kuptim i ndryshëm nenit 410/2 të KPP-së.

Në vlerësimin e faktit nëse vendimet riinterpretuese të Gjykatës, që përcaktojnë standarde të reja, kanë ose jo fuqi prapavepruese, çka përbën për ne thelbin e pretendimit konkret të cenimit të së drejtës së mbrojtjes, ne çmojmë se Gjykata duhet të marrë në konsideratë një test balancues që konsiston në tri faktorë: a) qëllimin e rregullit të ri të përcaktuar si pasojë e interpretimit; b) mbështetjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit mbi standardet e vjetra, në kuptimin e sigurisë juridike dhe, c) efektin që do të ketë fuqia prapavepruese në administrimin e drejtësisë.

Duke i vlerësuar standardet e reja të së drejtës së mbrojtjes të të gjykuarit në mungesë mbi bazën e këtij testi (shih për më tepër mendimin paralel të vendimit nr. 26, datë 08.05.2012, të GJK-së), dhe nisur nga rrethanat faktike të kësaj çështjeje, ne çmojmë se fuqia prapavepruese e vendimit nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës, në rastin konkret, i shtrin kufijtë e saj natyrorë deri në paprekshmërinë e situatave dhe raporteve juridike, tashmë të ezauruara në kohën që i paraprin interpretimit të ri.

Bazuar në argumentet e mësipërme, ne vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes është i pabazuar.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtarët në pakicë nuk jemi dakord me arsyetimin e shumicës. Argumentet tona janë të njëjta me ato që kemi paraqitur në mendimin e pakicës së vendimit nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, që i përket kërkesës së kërkuesit Ismet Boriçi.

Anëtarë: Admir Thanza , Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 34, datë 28.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i " "
Petrit Plloçi	Anëtar	i " "
Sokol Berberi	Anëtar	i " "
Admir Thanza	Anëtar	i " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e " "
Fatmir Hoxha	Anëtar	i " "
Vitore Tusha	Anëtare	e " "

me sekretare Enina Mullaj, në datën 15.11.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 45/20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Sinan Tafaj, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga znj. Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimin nga statusi i të verbrit", ndryshuar me VKM-të nr.870, datë 18.06.2008 dhe nr.602, datë 23.07.2010.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 16, 17, 18, 59/f, 131/c dhe 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, pika 2, 28, 49/2, 51, shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuesit, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, që kërkoi rrëzimin e saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit" ka miratuar vendimin nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit" që parashikon, midis të tjerash, se personave të verbër u njihet e drejta për të gëzuar një pagesë fikse, e cila do të indeksohet në bazë të pagës minimale.

2. Rregullimi i mësipërm nënligjor pësoi disa ndryshime, midis të tjerash, edhe me VKM-në nr.870, datë 18.06.2008 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", duke përcaktuar se pagesa për shkak të verbërisë do të vazhdonte të indeksohej me pagën minimale, por nuk do të rritej më shumë se pensioni minimal në shkallë vendi.

3. Formula e llogaritjes së pagesës për shkak të verbërisë ndryshoi sërish me VKM-në

nr.602, datë 23.07.2010 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", e cila parashikonte se masa e përfitimit për shkak të verbërisë është 9800 lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet me indeksin e çmimeve të konsumit.

II

4. ***Kërkuesi,*** Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë (SHVSH), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e pikës 4 të VKM-së nr.277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", e ndryshuar me VKM-të nr.870/2008 dhe nr.602/2010, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se:

4.1 Pagesa për shkak të verbërisë është përcaktuar si pagesë kompensuese me karakter social, e ndarë qartazi nga pagesa me karakter ekonomik. Ndryshimet e vazhdueshme, përmes akteve nënligjore, të mënyrës së llogaritjes së këtij përfitimi shtesë kanë sjellë cenimin e parimit të sigurisë juridike.

4.2 E drejta e pagesës për shkak të verbërisë, është një e drejtë themelore që bën pjesë në grupin e të drejtave sociale dhe që lidhet thelbësisht me të drejtat themelore të njeriut. Në këto kushte, kufizimi i kësaj të drejte është bërë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk justifikohet nga interesi publik apo gjendja e veçantë.

4.3 Aktet nënligjore kanë cenuar parimin kushtetues të zbatimit të drejtpërdrejtë të normave kushtetuese, në referim të nenit 4/2 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në referim edhe të nenit 59, shkronja "f" të Kushtetutës, është cenuar përmbushja e objektivit social të shtetit për përmirësimin e jetës së personave të paaftë dhe integrimin e tyre shoqëror.

5. ***Subjekti i interesuar***, Këshilli i Ministrave, pretendoi rrëzimin e kërkesës duke prapësuar si më poshtë:

5.1 *Në lidhje me legjitimimin:*

5.1.a Kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi kërkesa nuk përmban elementin formal të "përmbajtjes dhe parashtrimit të shkaqeve" në kuptim të nenit 28 të ligjit 8577, datë 2.10.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese". Mospërcaktimi i saktë i objektit të çështjes dhe natyra kushtetuese e së drejtës që pretendohet se cenohet nga VKM-të objekt kundërshtimi, sjell për pasojë mungesën e interesit të shoqatës dhe shkak të mjaftueshëm për papranueshmërinë e saj.

5.1.b Kërkuesi nuk plotëson kriterin e interesit për të vepruar, që ka të bëjë me titullaritetin e të drejtave të personave që efektivisht do të prekeshin nga VKM-të objekt kundërshtimi. SHVSH-ja nuk përfaqëson me tagra të plota përfaqësimi të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të individëve që janë me aftësi të kufizuara për shkak të verbërisë së tyre.

5.1.c Interesat e të verbërve dhe mbrojtja e tyre nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes realizohen nga vetë shteti, i cili i ka njohur Shoqatës së të Verbërve një rol aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve. Por statusi i saj mbetet ai palës konsultative në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. Në këto kushte, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet juridiksionit kushtetues pa shteruar më parë ankimin në rrugë administrative.

5.1.ç Kërkesa e paraqitur bie ndesh edhe me nenin 59 të Kushtetutës që parashikon në mënyrë të shprehur kushtin e realizimit të objektivave sociale në masën dhe brenda mjeteve që shteti disponon. Përmbushja e këtyre objektivave nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë.

5.1.d Kërkesa për shfuqizimin e VKM-së nr. 870/2008 është paraqitur tej afatit 3 vjeçar të parashikuar në nenin 50 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, për këtë pjesë të kërkesës Shoqata nuk legjitimohet ratione temporis.

5.2 *Në lidhje me themelin e kërkesës:*

5.2.a VKM-të objekt kundërshtimi nuk cenojnë parimin e sigurisë juridike, pasi ato janë akte nënligjore me natyrë ligj-zbatuese që parashikojnë programe dhe objektiva sociale, që për nga

natyra nuk mund të jenë të përhershme dhe të pandryshueshme. Parashikimi i skemave të ngurta sociale do të krijonte situata avantazhi ose disavantazhi për grupet e ndryshme sociale në shoqëri.

5.2.b E drejta për të pasur indeksim të masës së përfitimit në raport me pagën minimale nuk parashikohet as në nivel kushtetues e as në atë ligjor, për rrjedhojë, ky përfitim nuk mund të cilësohet si e drejtë themelore. Të drejtat sociale nuk janë drejtpërdrejt të ekzekutueshme si të drejtat e tjera themelore të individit.

5.2.c Parashikimi i mekanizmit indeksues të pagesës nuk nënkupton mohimin apo përjashtimin e të drejtës së pagesës për shkak të verbërisë, por përshtatjen e kësaj pagese me nivelin ekonomik të vendit. Ky shpërblim, i cili jepet mbi baza sociale, kushtëzohet nga kontrolli i shpenzimeve buxhetore dhe përdorimi i tyre në mënyrë sa më racionale, për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm.

III

A. Lidhur me legjitimimin e kërkuesit

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) përpara shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit, vlerëson të analizojë pretendimet e parashtruara nga subjekti i interesuar lidhur me legjitimimin e kërkuesit në këtë gjykim kushtetues.

7. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, për arsye se SHVSH-ja nuk ka përcaktuar objektin e çështjes dhe natyrën kushtetuese të së drejtës që pretendohet se i cenohet nga VKM-të objekt kundërshtimi. Kjo mangësi e elementeve formale sjell për pasojë mungesën e interesit të kërkuesit. Gjithashtu, kërkuesi nuk përfaqëson me tagra të plota përfaqësimi të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të individëve që janë me aftësi të kufizuara për shkak të verbërisë së tyre.

8. Çështjen e legjitimimit të kërkuesit *(locus standi)* Gjykata e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat që përfshihen në subjektin kushtetues "organizatat e tjera" janë të specifikuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar kësaj Gjykate, duke pasur legjitimitet vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata ka theksuar se interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit dhe se ky interes duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak *(shih vendimet nr.31, datë 18.06.2010 ; nr.4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Gjykata thekson se, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, që përcakton "organizatat e tjera" si subjekte që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, momenti i krijimit si dhe kohëzgjatja e veprimtarisë së tyre, nuk përbëjnë kusht për legjitimimin e këtyre subjekteve *(shih vendimin nr.17, datë 27.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Bazuar në aktet e administruara në këtë gjykim (statut dhe akt themelimi), Gjykata konstaton se kërkuesi është një subjekt juridik, krijuar në vitin 1991, i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2749, datë 10.04.1996. Anëtarë të shoqatës janë të gjithë personat të cilët kanë fituar statusin e të verbrit (neni 1). Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Ndryshe nga sa pretendon përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja "f" të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

11. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, legjitimohet *ratio temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

12. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata, bazuar në statutin e kërkuesit, konstaton se SHVSH-ja ka për qëllim, midis të tjerash, mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të të verbërve në mënyrë të organizuar dhe publike, integrimin e tyre, mbikëqyrjen e nivelit të jetesës dhe ndërmjetësimin në strukturat ligjvënëse dhe ekzekutive për përmirësimin e saj (neni 3). Po ashtu, Gjykata vëren se nenet objekt kundërshtimi përcaktojnë skemën e re për llogaritjen e mënyrës së pagesës për shkak të verbërisë, që parashikon vetëm indeksimin e kësaj pagese me indeksin e inflacionit për mallrat e konsumit.

13. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se bazuar në statutin dhe aktin e themelimit të kërkuesit, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin ata janë krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej tyre dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat e akteve nënligjore, objekt shqyrtimi, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, pasi provon dhe interesin për të vepruar i cili është i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak dhe, për rrjedhojë, vlerëson se pretendimi i përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

14. Kërkuesi ka pretenduar se ndryshimet e vazhdueshme të mënyrës së llogaritjes së pagesës së verbërisë, e cila është një pagesë kompensuese me karakter social, e ndarë qartazi nga pagesa me karakter ekonomik, sjell cenimin e parimit të sigurisë juridike. Ky përfitim i veçantë financiar bën pjesë në grupin e të drejtave sociale dhe lidhet thelbësisht me të drejtat themelore të njeriut.

15. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuara në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave *(shih vendimin nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Gjykata konstaton se Këshilli i Ministrave, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga neni 5 i ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", ka përcaktuar me vendim mekanizmin për përcaktimin e pagesës shtesë për shkak të verbërisë. Kjo pagesë llogaritej fillimisht në masën 70% të pagesës minimale shtetërore (pika 4 e VKM-së 227/1997). Në vitin 2008, pagesa shtesë për shkak të verbërisë u rrit në 8700 lekë në muaj, shumë e cila do të indeksohej çdo vit me ritmet e rritjes së pagës minimale në shkallë vendi, por masa e indeksuar nuk do të ishte më shumë se masa e pensionit minimal në qytet në shkallë vendi (VKM-ja 870, datë 18.06.2008). Në vitin 2009, pagesa shtesë për shkak të verbërisë u rrit në 9 800 lekë në muaj dhe indeksohej me të njëjtën

mënyrë si në vitin paraardhës. Në vitin 2010, pagesa shtesë për shkak të verbërisë mbeti e pandryshuar (9 800 lekë), por indeksohej me indeksin e çmimeve të konsumit (VKM-në nr. 602, datë 23.07.2010).

17. Gjykata vëren se pagesa për shkak të verbërisë, e parashikuar nga ligji dhe e konkretizuar me anë të akteve nënligjore si më sipër, përfitohet nga të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët, sipas kritereve mjekësore, janë të paaftë për punë në kushte normale. Gjithashtu, kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga të ardhurat e tjera që paguhen nga shteti, ajo nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie dhe përfitohet nga të verbrit pavarësisht nga mosha ose shkalla e paaftësisë, pra pavarësisht nëse ata i përkasin grupi të parë ku përfshihen të verbër të paaftë për punë në kushte normale, por që kanë nevojë për një kujdestar, ose grupit të dytë ku përshihen të verbër të paaftë për punë në kushte normale, të cilët janë në gjendje t'i shërbejnë vetes (neni 5 i ligjit nr.8098/1996 dhe neni 4 i VKM-së 277/1997, e ndryshuar).

18. Në vlerësimin e Gjykatës, ky përfitim financiar, i cili i përket grupit të përfitimeve shtesë që u paguhen të verbërve, është i një natyre tërësisht/ngushtësisht personale, i patransferueshëm, i patrashëgueshëm dhe gëzon një individualitet të dallueshëm nga pagesat apo përfitimet e tjera të kësaj kategorie. Kjo pagesë shtesë përbën një garanci më shumë në funksion të mbrojtjes dhe integrimit të kësaj kategorie në jetën normale.

19. Gjykata çmon se në kuadrin e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit social, është e drejtë legjitime e vetë shtetit të rregullojë sistemin e mbrojtjes sociale, duke hartuar dhe zbatuar politikat dhe strategjitë sociale. Në këtë kuptim, ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese *(shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në çdo rast, këto rregullime duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese dhe me detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Evropiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit.

20. Gjykata vlerëson se mbrojtja sociale e personave të paaftë realizohet përmes dy mekanizmave: *së pari*, nëpërmjet zbatimit të garancive të shprehura në të drejtat dhe liritë ekonomiko-sociale, të parashikuara në kreun IV të Kushtetutës dhe *së dyti*, nëpërmjet përmbushjes së objektivave socialë përmes materializimit të tyre në ligje, në referim të nenit 59 të Kushtetutës.

21. Përmbajtja e të drejtave ekonomiko-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive, duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar *(shih vendimin nr.33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Shteti, me qëllim garantimin e dinjitetit njerëzor, të një niveli të pranueshëm jetese, si dhe ruajtjen e interesave të të gjitha shtresave të shoqërisë, mund të ndryshojë mekanizmin e realizimit të këtyre të drejtave, veçanërisht kur nuk ka mundësi financiare për rishpërndarje proporcionale të fondeve në dispozicion, ose kur këto masa diktohen nga nevoja për të eliminuar apo parandaluar rreziqe reale ndaj sigurisë ekonomike. Në çdo rast, këto kufizime nuk duhet të cenojnë thelbin e së drejtës dhe duhet të respektojnë kërkesat kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

23. Mbrojtja sociale realizohet edhe përmes përmbushjes së objektivave socialë që shteti synon të realizojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësive private. Midis të tjerash, ato përfshijnë edhe synimin për riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës. Kushtet dhe masa në të cilat mund të kërkohet realizmi i

objektivave socialë i përket rezervës ligjore absolute, pra rregullimit me ligj të miratuar nga ligjvënësi.

24. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se të drejtat sociale dallojnë nga objektivat socialë, pasi këto të fundit janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të politikave të hartuara prej tij për orientimin e veprimtarisë në përgjithësi dhe, veçanërisht, të politikave sociale. Objektivat socialë janë shprehje e veprimit pozitiv të shtetit në favor të personave me aftësi të kufizuara dhe, për rrjedhojë, realizimi i tyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit.

25. Gjykata vlerëson se natyra e përfitimit për shkak të verbërisë është shprehje e mbrojtjes sociale e realizuar përmes përmbushjes së objektivave sociale, në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës. Ky përfitim nuk është element përbërës i pagës dhe si objektiv social përmbushet brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon Këshilli i Ministrave. Prandaj, përcaktimi, nga ky i fundit, i indeksit të çmimeve të konsumit si kriter për përllogaritjen e masës së pagesës për shkak të verbërisë është kriteri më i përshtatshëm, pasi i shërben zbutjes së efekteve negative që mund të shkaktojë inflacioni mbi situatën financiare të personave me aftësi të kufizuar dhe, rrjedhimisht, të kushteve të jetesës.

26. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë për cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i mënyrës së llogaritjes së pagesës për shkak të verbërisë nga VKM-të objekt kundërshtimi, është i pabazuar dhe, si i tillë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “c” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës të paraqitur nga kërkuesi, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Shumica, në këtë çështje, ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i mënyrës së llogaritjes së pagesës për shkak të verbërisë, është i pabazuar. Në arsyetimin e saj shumica ka çmuar se përmbushja e objektivave socialë, shprehje e së cilës është dhe përfitimi për shkak të verbërisë, nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Pakica, në ndryshim nga shumica, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me cenim të parimit të sigurisë juridike për arsyet që vijojnë.

Jurisprudenca kushtetuese e ka trajtuar gjerësisht parimin e shtetit të së drejtës, duke përcaktuar dhe veçoritë thelbësore të tij. Gjykata është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 20/2006 të Gjykatës Kushtetuese)*

Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore *(shih vendimin nr. 33/2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuara në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 18.06.2010; nr.9, datë 26.02.2007; nr.34, datë 20.12.2005)*.

Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitimë të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

Pakica rithekson se parimi i sigurisë juridike bashkëvepron edhe me parime të tjera si ai i shtetit social, i cili i siguron ligjvënësit një hapësirë të gjerë dhe të papërcaktueshme saktësisht për të rregulluar përfitimin e të mirave sociale në një masë dhe sasi të caktuar. Është detyrim i shtetit krijimi i mundësive për një jetesë dinjitoze të qytetarëve *(shih vendimin nr. 10, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Referuar preambulës dhe objektivave socialë të përcaktuar në Kushtetutë, shteti duhet t'u garantojë personave me aftësi të kufizuar një mbrojtje të veçantë sociale. Në kuadrin e shtetit social reflektohet edhe detyrimi i shtetit për të ndihmuar individët dhe grupet në nevojë të cilët, për shkak të paaftësive fizike dhe pamundësisë për të punuar, nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë të jetesës. Siç ka pohuar edhe shumica, natyra e përfitimit për shkak të verbërisë është shprehje e mbrojtjes sociale që realizohet përmes përmbushjes së objektivave socialë në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës. Kjo bëhet nëpërmjet një sistemi ligjor të përshtatshëm të miratuar nga ligjvënësi për përmirësimin e jetesës së këtyre personave si dhe për t'iu dhënë atyre mundësi të integrohen në shoqëri. Në çështjen konkrete, pakica nënvizon se pagesa mujore është një *e drejtë e fituar* e personave të verbër nga legjislacioni përkatës në fuqi, me natyrë sociale dhe karakter kompensues, e cila synon garantimin e kushteve për integrimin e tyre në jetën normale. Si e tillë, për arsye që vetëkuptohen, kjo e drejtë ka një rëndësi të veçantë.

Mekanizmi i ri indeksues i pagesës, duke ndryshuar një situatë ligjore të rregulluar më parë, e lidh përllogaritjen e vlerës monetare të pagesës mujore që iu takon të verbërve, me indeksin e çmimeve të konsumit. Si pasojë e përcaktimit të këtij kriteri të ri përllogaritës, vlera monetare e pagesës mujore ndryshon në varësi të indeksit të çmimeve të konsumit. Pakica pranon se Kushtetuta nuk ndalon çdo ndryshim të një situate të favorshme ligjore, por megjithatë kjo nuk do të thotë se këto lloj ndryshimesh nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit, rast pas rasti, për sa i përket kritereve objektive mbi bazën e të cilave është bërë ndryshimi. Detyrimi i shtetit për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar buron nga Kushtetuta, por rregullat e detajuara të sistemit të ndihmës shoqërore

nuk përcaktohen nga vetë Kushtetuta, ndaj në këtë drejtim ligjvënësi gëzon diskrecion në përcaktimin e këtyre rregullave. Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar; ligjvënësi duhet ta ushtrojë atë në respektim të Kushtetutës dhe në veçanti rregullimet ligjore nuk duhet të bëhen në mënyrë arbitrare, pasi kjo do të sillte papajtueshmëri të tyre me Kushtetutën. Në regjimin e mëparshëm (përpara ndryshimeve të vitit 2010 me VKM-të përkatëse) kriteri referues për përllogaritjen e pagesës ishte paga minimale, ndërsa në regjimin aktual në fuqi kriteri i ri referues është indeksi i çmimeve të konsumit. Sipas statistikave zyrtare, indeksi i çmimeve të konsumit, i cili përbën treguesin kryesor të nivelit të inflacionit, është mjaft i paqëndrueshëm dhe i luhatshëm, duke pësuar ulje - ngritje të vazhdueshme. Nga ana tjetër, paga minimale dhe ndryshimet që ajo pëson, ndikohen nga një mori faktorësh duke përshirë, midis të tjerash, jo vetëm inflacionin në nivel kombëtar por edhe rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB ose 'GDP') si dhe elemente të tjera të progresit social si p.sh. kërkesat e ofertat e punësimit, kushtet e punësimit, rritjen e produktivitetit, kostot e punës, lirinë ekonomike, standardin e jetesës etj. Pra siç shihet, paga minimale, duke qenë se përcaktohet mbi bazën e një sërë faktorësh ekonomikë, si kriter përllogaritës ofron më tepër stabilitet dhe qëndrueshmëri sesa indeksi i çmimeve të konsumit, i cili është vetëm një nga faktorët që influencon në rregullimin e pagës minimale. Çmimet e konsumit mund të ndryshojnë për motive nga më të ndryshmet si p.sh. politika të gabuara apo kriza të naftës dhe gazit, faktorë të cilët nuk mund të ndikojnë fare në ndryshimin e pagës minimale.

Duke pasur parasysh luhatjen dhe paqëndrueshmërinë e indeksit të çmimeve të konsumit, rrjedhimisht edhe kriteri i ri i indeksimit me indeksin e çmimeve të konsumit, për përllogaritjen e pagesës mujore, mbart në vetvete arbitraritet. Në vlerësimin e pakicës, ndryshimet konkrete, të cilat e shkëpusin përllogaritjen e pagesës mujore nga kriteri i pagës minimale dhe e lidhin me parametrin e luhatshëm të inflacionit, nuk garantojnë stabilitet dhe qartësi të mjaftueshme për të shmangur arbitraritetin.

Pakica e çmon të rëndësishme të theksojë se ndryshimi i një situate ligjore të caktuar nuk duhet bërë në mënyrë arbitrare, pa kritere të qarta apo në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës. Është pranuar si rregull se thjesht një ndryshim i një rregullimi ligjor të caktuar nuk përbën, a priori, cenim të parimit të sigurisë juridike. Çdo ndryshim duhet të vlerësohet edhe në raport me interesat publike të cilat e kanë detyruar ligjvënësin të ndërmarrë iniciativa për të ndryshuar një situatë juridike të caktuar. Parimi i sigurisë juridike, në thelb, garanton individin se shteti nuk do të përkeqësojë në mënyrë arbitrare pozitën e tij ligjore, çka do të thotë pa një shkak të bazuar në interesin legjitim publik që mbizotëron. Subjekti i interesuar në këtë çështje, për të mbështetur ndryshimet e bëra, ka evidentuar në pretendimet e tij situatën e pafavorshme ekonomike dhe rëndesën që kjo lloj pagese ka mbi buxhetin e shtetit. Në këtë aspekt, pakica pranon se pamundësia buxhetore e shtetit për të paguar detyrimet e tij është një interes legjitim publik dhe në këtë këndvështrim Gjykata nuk mund të marrë rolin aktiv të ekspertit për të gjykuar mbi politikat ekonomike dhe sociale të shtetit. Edhe GJEDNJ-ja ka pohuar se "shteteve u njihet një hapësirë e gjerë vlerësimi në zbatimin e politikave ekonomike dhe sociale *(shih çështjen Jahn, e të tjerë kundër Gjermanisë, datë 30.06.2005, paragrafi 91)*.

Sipas Kushtetutës, përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejtë në gjykatë (neni 59/2). Kjo nënkupton se përfshirja në Kushtetutë e objektivave socialë të shtetit (neni 59) nuk përbën në vetvete një të drejtë të individit për t'iu drejtuar gjykatës për çdo lloj pretendimi kundër shtetit por thjesht i imponon shtetit detyrën për të vënë në zbatim politika efektive që kanë si qëllim realizimin e këtyre objektivave programatikë me natyrë sociale. Në këtë linjë arsyetimi, këto lloj objektivash nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme apo të vetëzbatueshme.

Ne mendojmë se, ajo që është esenciale në rastin konkret, nuk ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së vlerës monetare të pagesës mujore, si mjet kompensues, që do të nënkuptonte dhënien nga Gjykata të një drejtësie sociale, por me vlerësimin nëse kriteret ligjore që ligjvënësi ka përcaktuar për llogaritjen e vlerës monetare të kësaj pagese janë apo nuk janë arbitrare, aq më tepër

kur kemi të bëjmë me rregullimin e të drejtave të fituara. Në këtë kontekst është e qartë se të verbërve nuk iu garantohet detyrimisht një e drejtë për të përfituar një masë/nivel pagese specifike të paracaktuar në vlerë monetare apo një shtesë të kësaj pagese, të cilën shteti është i detyruar t'ua japë, por nëse masa/niveli i kësaj pagese përcaktohet nga ligjvënësi në mënyrë arbitrare, pa kritere ligjore të qarta e të qëndrueshme, nuk mund të pranohet se një gjë e tillë është në përputhje me Kushtetutën. Ndryshe nga paga minimale, kriteri ligjor në fuqi nuk karakterizohet nga i njëjti stabilitet, pasi i referohet indeksit të çmimeve të konsumit, i cili është i luhatshëm dhe i paqëndrueshëm.

Gjithashtu pakica evidenton se me formulën e re në fuqi, sipas udhëzimit nr. 114, datë 4.8.2011 të Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke filluar nga data 1 shtator 2011, masa e përfitimit për shkak të verbërisë është llogaritur në 9 300 lekë/muaj. Nëse kjo pagesë do të llogaritej me formulën e vjetër mbi bazën e pagës minimale shtetërore, do të ishte 70% e 19 000 (paga minimale aktuale sipas VKM nr. 566, dt. 14.07.2010) = 13 300 lekë/muaj. Siç duket qartë, pagesa mujore për shkak të verbërisë ka pësuar një përkeqësim në vlerë monetare me ndryshimet ligjore, të cilat janë objekt shqyrtimi.

Nisur nga argumentet e mësipërme, pakica çmon se pretendimi i kërkuesit në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike është i bazuar dhe duhej të pranohej nga Gjykata.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

VENDIM
Nr. 35, datë 30.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e "	"
Fatmir Hoxha	Anëtar	i "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.04.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Zharin Divintari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, Zyra e Përmbarimit Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuesi ka filluar punë në administratën doganore në datën 08.08.1997. Me aktin nr. 6331, datë 11.08.2003, është emëruar kryetar i Degës Detare të Kontrabandës. Mbi bazën e VKM-së nr. 612, datë 11.09.2003 "Për strukturën organike dhe analitike të administratës doganore" kërkuesi është transferuar në detyrën shef i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe ka qëndruar në këtë detyrë deri në daljen e aktit nr. 8201 prot., datë 21.10.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, sipas të cilit ai është liruar nga detyra dhe është lënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) për t'u emëruar në një detyrë tjetër.

2. Ky akt është bërë objekt shqyrtimi administrativ në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili me vendimin nr. 12, datë 26.01.2006, ka shfuqizuar aktin nr. 8201 prot., datë 21.10.2005, si të pabazuar në ligj dhe ka urdhëruar "kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës si shef i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe pagimin e pagës për gjithë kohën e qëndrimit pa punë nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare". Ky vendim i KSHC-së është ankimuar nga DPD-ja në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në datën 07.03.2006, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka nxjerrë aktin nr. 2877 prot., me anë të të cilit ndaj kërkuesit është marrë masa disiplinore e "largimit nga puna". Edhe ky akt është kundërshtuar nga kërkuesi përpara KSHC-së, i cili me vendimin nr. 437, datë 15.06.2006, ka vendosur shfuqizimin e tij si akt absolutisht i pavlefshëm.

3. Pas ankimit të ushtruar nga DPD-ja, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 184, datë 03.11.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2007-849, datë 22.06.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit me motivacionin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

5. Kërkuesi, me anë të një shkrese, i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave të ekzekutojë vendimin nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së që është lënë në fuqi nga vendimi nr. 184, datë 03.11.2006 i Gjykatës së Apelit Tiranë, i formës së prerë. Ai ka kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagesat përkatëse për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Më pas, kërkuesi i ka kërkuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë zbatimin e vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së dhe Zyra e Përmbarimit, mbi bazën e kësaj kërkese, ka nisur procedurat përmbarimore.

6. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata"), duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, të lënë në fuqi nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Ai ka argumentuar se është larguar nga puna në mënyrë të paligjshme dhe DPD-ja nuk ka zbatuar detyrimet që buronin nga vendimi i KSHC-së për rikthimin e tij në punë dhe dhënien e pagesave përkatëse.

7. *Subjekti i interesuar*, DPD-ja ka paraqitur me shkrim prapësimet e saj, duke pretenduar se:

7.1 Kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ankimit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi vendimi nr. 12, datë 26.01.2006 i KSHC-së, i cili është i vetmi vendim që ka përcaktuar "rikthimin në punë dhe pagesat përkatëse", është prishur nga Gjykata e Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; ndaj vendimit të kësaj gjykate pas rigjykimit kërkuesi nuk ka ushtruar ankim.

7.2 Është parashkruar afati dy vjeçar për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

7.3 Pretendimi i kërkuesit është i pambështetur për arsye se i vetmi vendim i formës së prerë ka disponuar shfuqizimin e aktit të administratës doganore për largimin nga puna, ndaj, në këto kushte, nuk ekziston ndonjë detyrim për t'u ekzekutuar nga administrata doganore.

II

A. Për pretendimin e moslegjitimimit të kërkuesit si pasojë e mosshterimit të mjeteve ligjore

8. Subjekti i interesuar, DPD-ja, ka pretenduar se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ankimit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky cenim, sipas kërkuesit, ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 184, datë 03.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, duke detyruar administratën doganore ta rikthejë kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i paguajë pagën për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

9. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ") *(shih vendimin nr. 6, datë 07.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Sipas Gjykatës, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të të drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë *(shih vendimet nr. 6, datë 06.03.2009; nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura dhe parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, DPD-së, Gjykata konstaton se kërkuesi ka qenë palë në tre procese gjyqësore të veçanta që lidhen me largimin e tij nga puna si Shef Sektori i Antikontrabandës Tokësore në administratën doganore.

i) *Procesi në lidhje me aktin administrativ nr. 8201, datë 21.10.2005 (vënia e kërkuesit në dispozicion)*

11. Kërkuesi, me aktin administrativ nr. 8201 prot. datë 21.10.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është liruar nga detyra dhe është lënë në dispozicion të DPD-së. Kjo ka ndodhur për arsye të shkurtimit të vendit të punës në bazë të VKM-së nr. 686, datë 02.11.2005 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 205, datë 13.04.1999". Ky akt administrativ është kundërshtuar nga kërkuesi në KSHC, i cili, nëpërmjet vendimit nr. 12, datë 26.01.2006, ka vendosur "shfuqizimin e aktit nr. 8201 prot., datë 21.10.2005, si të pabazuar në ligj duke urdhëruar kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës si shef i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore; dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi". DPD-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 80, datë 27.06.2006, ka lënë në fuqi vendimin nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së. Ndaj këtij vendimi DPD-ja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë e cila, me vendimin nr. 183, datë 07.05.2009, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 80, datë 27.06.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 7966, datë 07.10.2009, ka vendosur pushimin e gjykimit. Kërkuesi, për vënien në zbatim të vendimit nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së, i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë. Fillimisht, me shkresën nr. 4576, datë 07.05.2007 Zyra e Përmbarimit i ka dërguar DPD-së "lajmërim për ekzekutim vullnetar" të urdhrit të ekzekutimit nr. 111, datë 15.03.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë për zbatimin e vendimit nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së. Më tej, Zyra e Përmbarimit ka marrë vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, por pasi është vënë në dijeni në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për rigjykim dhe prishjen e vendimit nr. 12,

datë 26.01.2006 të KSHC-së, ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 111, datë 15.03.2007.

ii) *Procesi në lidhje me aktin administrativ nr. 2877, datë 07.03.2006 (largimi i kërkuesit nga puna)*

12. Me aktin administrativ nr. 2877 prot., datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, kërkuesi është larguar nga puna dhe ndaj këtij akti ai ka paraqitur ankim në KSHC. Pasi ka konstatuar se akti i largimit të kërkuesit nga puna është absolutisht i pavlefshëm, me vendimin nr. 437, datë 15.06.2006, KSHC-ja ka vendosur shfuqizimin e aktit nr. 2877 prot. datë 07.03.2006 si të pabazuar në ligj. DPD-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të KSHC-së në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 184, datë 03.11.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së. Ndaj këtij vendimi DPD-ja ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

iii) Procesi në lidhje me padinë e re të paraqitur nga kërkuesi për zbatimin e vendimit nr. 437, datë 16.06.2006 të KSHC-së

13. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përmes një kërkesëpadie të re, duke kërkuar zbatimin e vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, rikthimin në punë dhe pagesën e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 179/1 të Kodi të Procedurës Civile (KPC), me vendimin nr. 128, datë 23.02.2011 ka vendosur pushimin e gjykimit.

14. Nga aktet e mësipërme, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Sipas parashikimit të këtij neni, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, *pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.* Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin, që për zgjidhjen e çështjes së tij, t'iu drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi *(shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Gjykata vëren se vendimi nr. 12, datë 26.01.2006 i KSHC-së, i cili është i vetmi vendim që ka përcaktuar në dispozitiv rikthimin në punë të kërkuesit dhe dhënien e pagesave përkatëse, është prishur nga Gjykata e Lartë dhe çështja është rikthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit ka vendosur pushimin e çështjes dhe ky vendim ka marrë formë të prerë, duke filluar nga data 12.10.2009, për shkak se kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj tij. Për pasojë, nga momenti që vendimi për pushimin e çështjes ka marrë formë të prerë, ka rënë dhe pretendimi i kërkuesit për rikthim në punë apo pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë. Megjithatë, tre vjet më vonë kërkuesi, duke u bazuar te vendimi nr. 437, datë 15.06.2006 i KSHC-së, ka kërkuar sërish rivendosjen e së drejtës për rikthim në punë dhe pagesat përkatëse me anë të një padie të re. Sipas akteve të administruara të dosjes gjyqësore rezulton se vendimi nr. 437, datë 15.06.2006 i KSHC-së, te i cili kërkuesi mbështet pretendimet e tij, është një vendim deklarativ që ka shfuqizuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për largimin nga puna të kërkuesit dhe nuk disponon për rikthimin në punë të tij apo dhënien e pagesave përkatëse nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Për më tepër, ky vendim nuk shprehet as mbi rregullimin e pasojave që rrjedhin nga shfuqizimi i aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Mbi padinë e re Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit dhe përsëri kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

16. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi, duke mos ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, mbi bazën e të cilave kërkon rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, nuk i ka shteruar të gjitha mjete juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

17. Përfundimisht, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për arsye të mosshterimit të mjeteve ligjore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

UDHËZIM
Nr. 17, datë 11.5.2012

MBI PËRCAKTIMIN E KOHËS SË MBAJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE QË PËRPUNOHEN NË SISTEMET ELEKTRONIKE, NGA ORGANET E POLICISË SË SHTETIT PËR QËLLIME PARANDALIMI, HETIMI, ZBULIMI DHE NDJEKJE TË VEPRAVE PENALE

Mbështetur në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 30 dhe shkronjën "ç" të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Zbatimin e rregullave për përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale në sistemet elektronike, që përdoren nga organet e Policisë së Shtetit, për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale.

I. Fusha e veprimtarisë

1. Të dhënat personale të përpunuara për një apo disa qëllime të caktuara nuk mbahen për një afat më të gjatë sesa është e nevojshme për arritjen e këtij apo këtyre qëllimeve. Ky është parimi në të cilin duhet të bazohet puna e policisë për sa i përket kohës së mbajtjes së të dhënave personale nga ana e saj.

2. Personeli i policisë duhet të respektojë të gjitha procedurat e kohës së mbajtjes së të dhënave personale për të siguruar që të dhënat personale janë përpunuar, janë përditësuar dhe ato që nuk janë më të nevojshme, janë fshirë nga banka e të dhënave.

3. Ky udhëzim aplikohet për të gjitha sistemet elektronike të Policisë së Shtetit dhe në veçanti, të Policisë Gjyqësore, të cilat përdoren për parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale.

II. Rregulli i përgjithshëm

1. Të dhënat personale duhet të fshihen ose të bëhen anonime në momentin që ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga ana e Policisë së Shtetit dhe nga ana e Policisë Gjyqësore, në veçanti.

III. Periudhat e rishikimit

1. Të dhënat personale të mbajtura elektronikisht, vlerësohen në lidhje me domosdoshmërinë për vazhdimin e mbajtjes së tyre çdo:

a) dy vjet për të dhënat personale në lidhje me vepra penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon deri në dy vjet heqje lirie;

b) tre vjet për të dhënat personale në lidhje me vepra penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon deri në dhjetë vjet heqje lirie;

c) pesë vjet për të dhënat në lidhje me vepra penale, dënimi për kryerjen e të cilave shkon mbi dhjetë vjet heqje lirie.

2. Nëse të dhënat personale të përfshira në një proces rishikimi do të vlerësohen për t'u mbajtur me qëllim parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të ndryshme me dënime maksimale të ndryshme, periudha e rishikimit do t'i korrespondojë masës maksimale të dënimit të parashikuar për veprën penale më të rëndë.

3. Nëse pas rishikimit të kohës së mbajtjes së të dhënave, vendoset që ato do të vazhdohen të mbahen në sistemet elektronike, atëherë fillon një periudhë e re rishikimi.

4. Vendimi për vazhdimin e mbajtjes së të dhënave regjistrohet në një regjistër të posaçëm për qëllimin e vetëm të kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së tij sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë akt në veçanti. Të dhënat e ruajtura në regjistër do të përmbajnë, të paktën, numrin, datën dhe orën e marrjes së vendimit, arsyen për mbajtjen e të dhënave, si dhe përcaktimin e qartë të identitetit të oficerit të policisë që ka marrë vendimin.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përcakton në çdo rast oficerët e policisë që do të kryejnë vlerësimin dhe që do të marrin vendimin për vazhdimin e mbajtjes apo të fshirjes së të dhënave personale të përpunuara.

6. Nëse koha e mbajtjes së të dhënave personale rishikohet tri herë pas këtij afati, vendimi për rishikim miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ose Drejtori i Drejtorisë së Policisë së Qarkut (qarqeve), ose Drejtori Rajonal i Policisë Kufitare, përveç rasteve kur aplikohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Kur të dhënat për personin janë përditësuar ose konsultuar (aksesuar) vazhdimisht, veçanërisht nëse informacione të reja janë shtuar gjatë gjashtë muajve të fundit;

b) Kur ka të dhëna të qarta, bazuar në fakte, se personi i përket ose është i lidhur ngushtë me një organizatë kriminale ose terroriste;

c) Kur, sipas studimeve përkatëse shkencore apo statistikore, lloji i krimit, lidhur me të dhënat e mbajtura mbi personin, ka shumë të ngjarë që të kryhet sërish prej tij. Një listë e qartë e këtyre kategorive krimesh duhet të miratohet nga Ministri i Brendshëm.

7. Periudha e rishikimit të ardhshëm ndërpritet gjatë kohës që personi kryen dënimin me burgim dhe fillon sërish me daljen e tij nga burgu.

IV. Kriteret për rishikimin e domosdoshmërisë për të vazhduar mbajtjen e të dhënave

1. Për përcaktimin e domosdoshmërisë për mbajtjen e të dhënave personale, do të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

a) Mosha e subjektit të të dhënave, duke treguar kujdes të veçantë për minorenët dhe të moshuarit;

b) Shuarja e dënimit. Nëse një person e ka kryer dënimin me burgim dhe ndërkohë edhe periudha e parë e rishikimit ka kaluar, të dhënat personale të tij do të fshihen, përveç rasteve kur ekzistojnë prova që vërtetojnë se ato janë të domosdoshme për hetime të tjera në proces. Në rastin e

të dhënave sensitive, ato do të fshihen, përveç se kur janë absolutisht të nevojshme për t'i mbajtur për shkak të hetimeve të tjera në proces.

c) Për vendimet e gjykatës, veçanërisht vendimet e saj për shpalljen e pafajësisë në lidhje me vepra penale të veçanta, i gjithë informacioni në lidhje me to duhet të fshihet, përveç rasteve kur ekzistojnë prova që vërtetojnë se ato janë të domosdoshme për hetime të tjera në proces. Në rastin e të dhënave sensitive, ato do të fshihen, përveç se kur janë absolutisht të nevojshme për t'u mbajtur për shkak të hetimeve të tjera në proces. I njëjti kusht mund të aplikohet edhe për rastet e amnistisë apo të rehabilitimit.

V. Sinjalizimi

1. Në sistemin elektronik të Policisë së Shtetit lëshohet një sinjal (alert) dy muaj para afatit të rishikimit të kohës së mbajtjes së të dhënave personale.

2. Nëse është përmbushur afati dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për rishikimin e kohës së mbajtjes së të dhënave nga oficeri përkatës i policisë, atëherë këto të dhëna do të fshihen.

VI. Të dhënat për personat e shoqëruar, të ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit

1. Të dhënat personale për personat e shoqëruar, të ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, nuk mbahen për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rastit kur ka arsye të rëndësishme për mbajtjen e tyre, bazuar në fakte, që tregojnë se ato janë të nevojshme për qëllime të një hetimi në proces ose për një proces gjyqësor.

2. Në rast se të dhënat personale të personave të shoqëruar, të ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, mbahen për më shumë se gjashtë muaj për shkak se janë të nevojshme për qëllime të një hetimi në proces ose procesi gjyqësor, do të aplikohen të njëjtat rregulla për afatet e rishikimit të përcaktuara në këtë udhëzim.

VII. Regjistrimi dhe mbikëqyrja

1. Qëllimi për mbajtjen e regjistrit të përmendur në pikën 4 të kapitullit III është të krijojë një mekanizëm kontrolli të përshtatshëm për të kryer verifikimin e ligjshmërisë së vendimit për vazhdimin e mbajtjes së të dhënave personale.

2. Të dhënat që përmban ky regjistër do të fshihen në të njëjtën kohë me të dhënat personale të lidhura me to, përveç se kur janë të nevojshme për kontrolle ose për procese gjyqësore në vazhdim.

3. Kontrolli i regjistrit bëhet në mënyrë periodike nga Drejtoria e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave për të verifikuar pajtueshmërinë me rregullat për kohën e mbajtjes së të dhënave, si dhe me rregullat për mbrojtjen e të dhënave.

4. Të dhënat e regjistrit do të vihen në dispozicion të autoriteteve me kompetenca mbikëqyrëse si brenda, dhe jashtë policisë, dhe në veçanti, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri.

5. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të përdorë informacionin që përmban regjistri gjatë ushtrimit të kompetencave të tij kontrolluese dhe mbikëqyrëse, në mënyrë që të sigurohet që përpunimi i të dhënave personale nga ana e policisë është kryer në mënyrë të ligjshme si gjatë kryerjes së inspektimeve kryesisht, ashtu edhe në rast ankese nga subjekte të dhënash.

VIII. Konfidencialiteti

1. Të gjitha strukturat policore, personat/punonjësit që zbatojnë këtë udhëzim detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, edhe pas përfundimit të funksionit.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Policia e Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

VENDIM
Nr. 59, datë 10.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "POWER ELEKTRIK SLLABINJË" SHPK ME NR. 93, SERIA PV10K, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 10, DATË 8.2.2010

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa "b" pika 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Power Elektrik Sllabinjë" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 93, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 10, datë 8.2.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "Power Elektrik Sllabinjë" sh.p.k. plotëson kërkesat e "Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a":
- Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).
- Neni 15, pika 4, germa "b":
- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë "Power Elektrik Sllabinjë" me nr. 93, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec "Sllabinjë" me fuqi 9.3 MW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 60, datë 10.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË HEC "BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2" SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9, nenit 13 pika 1 germa "ç" dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "f", nenit 8 pika 4 dhe nenit 10 pikat 1 dhe 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa "a" dhe 3 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht (mungon neni 9, pika 3, germa "a" (vërtetim për shlyerjen e tatim taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore); neni 9, pika 3, germa "b"; (Paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit); neni 9, pika 3, germa "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe strukturat e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.)
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b" dhe "c") subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 61, datë 10.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "GJO SPA POWER" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "LAPAJ"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "a", dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 nenit 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Gjo Spa Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GJO SPA POWER" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "GJO SPA POWER" sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Lapaj".
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 62, datë 10.5.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "GJO SPA POWER" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Gjo Spa Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GJO SPA POWER" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "GJO SPA POWER" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 63, datë 10.5.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "KURUM ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", nenit 5 pika 1 germa "g" dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e

Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Kurum Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Kurum Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Kurum Energy" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 64, datë 10.5.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "KURUM ENERGY" SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9, dhe neneve 13 pika 1 germa "ç", 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "f", nenit 5 pika 1 germa "f", nenit 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Kurum Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Kurum Energy" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Kurum Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 65, datë 28.5.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HENZ ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "DARSI 1", "DARSI 2", "DARSI 3"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "a", nenit 5 pika 1 germa "a" dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Henz Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Henz Energy" sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Darsi 1" me fuqi 2,24 MW, "Darsi 2" me fuqi 7,633 MW, "Darsi 3" me fuqi 1,066 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.6.2012
Doli nga shtypi më 13.6.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë